

VENDIM
Nr. 143, datë 27.11.2020

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME URA VAJGURORE
SHA**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 27.11.2020, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Ura Vajguore sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Ura Vajguore (UK Ura Vajguore), me shkresën nr. 64 prot., datë 28.9.2020, si dhe plotësimet me shkresat përcjellëse nr. 77 prot., datë 26.10.2020, dhe nr. 81 prot., datë 9.11.2020, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, të UK Ura Vajguore, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe në Rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63 datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM-ja nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) Shoqëria UK Ura Vajguore ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 16 560 banorë të Bashkisë Dimal (Ura Vajguore);

b) Drejtuesja teknike e shoqërisë UK Ura Vajguore, znj. Jolanda Gjordeni, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së ndërtimit, dega Hidroteknikë në vitin 2013, plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Ura Vajguore, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësitë tekniko-profesionale, aftësitë financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjiellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Ura Vajguore është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Ura Vajguore sh.a. me (NUIS: K32803022R), në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Ura Vajguore sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues Ligjor: Petref Sula;

b) Drejtuese Teknike: Jolanda Gjordeni.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Ura Vajguore sh.a. është Bashkia Dimal (Ura Vajguore).

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Ura Vajguore sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Ura Vajguore sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani